



REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

Në bazë të nenit 43.1 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 28 paragrafi 1 i Statutit 01.Nr-209/22 të Komunës së Vushtrrisë dhe nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores për Punën e Kuvendit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë:

Ju fton

Të merrni pjesë në mbledhjen e Kuvendit të Komunës, e cila do të mbahet më datë **26 shtator 2024 (e enjte), me fillim në ora 10:00.** Mbledhja do të mbahet në sallën e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë.

Për këtë mbledhje propozohet ky:

R E N D D I T E

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 25 korrik 2024.
2. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim – buxhetit për vitet 2025 – 2027 dhe planeve investuese
3. Shqyrtimi i Raportit për situatën ekonomiko-financiare dhe zbatimin e planeve investuese, për periudhën janar – qershor 2024
4. Shqyrtimi i Raportit i sistemit të menaxhimit të performancës dhe grantit të performancës për vitin 2023
5. Shqyrtimi i Informatës për përfundimin e gjysmëvjetorit të dytë të vitit shkollor 2023/2024
6. Shqyrtimi i nismës së Kryetarit të Komunës për bashkëpunim ndërkomunal për bashkëfinancim me Komunën e Mitrovicës për rregullimin e memorialit të dëshmorit Xhevat Jusufi
7. Rishikimi i Planit të veprimit për të gjeturat e auditorit
8. Shqyrtimi i Informatës për përfundimin e korrije – shirjeve dhe përgatitjet për mbjelljet vjeshtore
9. Shqyrtimi i Informatës lidhur me punën e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për gjashtëmujorin e parë të vitit 2024
10. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit me numër të protokollit Nr.01-63/24 i datës 28.03.2024 për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme komunale.
11. Pyetje dhe përgjigje.

Melihate Basholli-Latifi

Kryesuese e Kuvendit të Komunës

